



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1531 Prot.

Lezhë, më 02 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 3, Datë 28. 01. 2026

**PËR MIRATIMIN E AKT-MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET  
BASHKISË LEZHË DHE KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR, DEGA LEZHË**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar , në Kodin Civil, neni 79 e në vijim, ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001, për organizatat jofitimprurëse, i ndryshuar, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, VKM 626, datë 21.09.2004 “Për miratimin e listave të inventarit dhe transferimin në pronësi të bashkive dhe njësisve administrative të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ngritjen e qendrave të shërbimeve sociale”, vertetimin hipotekor nr.212, datë 13.07.2006, VKM nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”, statutin e Kryqit të Kuq Shqiptar, miratuar nga Asambleja e Parë e Përgjithshme e KKSH-së me 23-24.11.1992, rishikuar në Asamblenë e Dytë me 22-23.06.1995, në Asamblenë e Katërt me 27-29 Tetor 2000 dhe në Asamblenë e Njëmbëdhjetë me 10 Nëntor 2007, dhe Akt-Marrëveshjen Nr.685 Prot datë 19.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**Vendosi:**

1. Miratimin e Akt-Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq, Dega Lezhë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI




sh/social



**BASHKIA LEZHË**

Nr. 685 Prot.

Lezhë, më 18.01.2026



**KRYQI KUQ SHQIPTAR  
DEGA LEZHË**

Nr. 3 Prot.

Lezhë, më 14.01.2026

**AKT- MARRËVESHJE**

Sot, me datë më \_\_\_\_\_.2026 , lidhet kjo akt marrëveshje ndërmjet palëve

**Bashkia Lezhë - person juridik me adresë** Lagjia “Skëndërbeg”, sheshi “Gjergj Kastrioti” përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë Z. Pjerin Ndreu, këtej e tutje e cilësuar Bashkia Lezhë.


dhe

**Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë** shoqatë e pavarur, humanitare, vullnetare, e themeluar ne Tiranë me 4 Tetor 1921 dhe miratuar me dekretin nr.246/1 datë 4 Maj 1922 të Këshillit të Lartë të Shtetit. Kryqi i Kuq Shqiptar vepron në baze te ligjit nr.7864 datë 29.09.1994. Mbështetet në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollet shitesë të vitit 1977, ku ka aderuar dhe Shqipëria si dhe në parimet themelore të Lëvizjes Ndërkobëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysëm Hënës së Kuqe, me adresë Lagjia “Beslidhja”, Pallati pas “Stadiumit” regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5622 datë 15.07.1993 me NIPT J62103001W, e përfaqësuar këtu ligjërisht nga Jolanda Gjeçi sekretar i Kryqit të Kuq Shqiptar Dega Lezhë, këtej e tutje e cilësuar si KKSH Dega Lezhë.

Palët bien dakord të hartojnë këtë akt-marrëveshje me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

**Neni 1  
Baza Ligjore**

Mbështetur në Kodin Civil, neni 79 e në vijim, ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001, për organizatat jofitimprurëse, i ndryshuar, ligji nr. 9355 date 10.03.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, VKM 626 datë 21.09.2004 për miratimin e listave të inventarit dhe transferimin në pronësi të bashkive dhe njësive administrative të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ngritjen e qendrave të shërbimeve sociale, vërtetimin hipotekor nr.212 datë 13.07.2006 VKM nr 658 datë 17.10.2005, për standartet e shërbimeve shoqërore, statutin e Kryqit të Kuq Shqiptar, miratuar nga Asambleja e Parë e Përgjithshme të KKSH-së me 23-24.11.1992, rishikuar në Asamblenë e Dytë me 22-23.06.1995, në Asamblenë e Katërt me 27-29 Tetor 2000 dhe në Asamblenë e Njëmbëdhjetë me 10 Nëntor 2007,



Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

## Neni 2

### Ojekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje, është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të ndërsjellta në zbatimin e ofrimit të shërbimeve sa me cilësore për grupet sociale si të moshuar, gra dhe vajza në nevojë e familje me vështirësi social-ekonomike.

Baza e kësaj marrëveshje është funksionimi i qendrës multifunktionale, pranë gjimnazit të vjetër "Hydajet Lezha" dhe ofrimit të shërbimeve pranë kësaj qendre nga Bashkia Lezhe dhe Kryqi i kuq, Dega Lezhe.

## Neni 3

### Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord si më poshtë:

#### **Bashkia Lezhë**

Merr përsipër:

- Vënie në dispozicion të ambjenteve pranë ish gjimnazit Hydajet Lezha, pronë publike e Bashkisë Lezhë, Kryqit të Kuq Shqiptar Dega Lezhë.
- Pas përfundimit të kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje Bashkia dhe Kryqi i Kuq dega Lezhë dakortësojnë për ripërsëritjen e marrëveshjes .
- Të likujdojë faturat e energjisë elektrike dhe ujësjellës kanalizime.
- Të alokojë në shumën 60.000 lekë/vit Kryqit të Kuq për pagesën e kordinatorit që do të përgjigjet për qendrën ditore pasdite dhe gjatë fundjavës, periudhë kur nuk mbulohet nga Kryqi i Kuq Dega Lezhë.
- Të alokojë shumën 140.000 lekë/vit për aktivitete festive menjëherë pas miratimit të kësaj marrëveshjeje.

#### **Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Lezhë**

Merr përsipër:

- Të ofrojë shërbime sociale, kulturore e mjekësore për të moshuarit.
- Të ofrojë kurse formimi profesional për gratë dhe vajzat ne nevojë (kur gjenden donatorët) .
- Të përgjigjet për mirëfunksionimin e kësaj qendre duke marrë përsiper likujdimin e të gjitha shpenzimeve (Kordinator, mjek, kafë, çaj, lojra, aktivitete, shtyp ditor, mbështetje ushqimore dhe veshmmbathje etj.)
- Mirëmbajtjen e Qendrës së formimit profesional për gra e vajza në nevojë duke marrë përsiper likujdimin e të gjitha shpenzimeve (Kordinator, punonjës social,mjek, facilitator biznesi, materiale për kursin si makina qepëse, metrazhe,etj të gjitha këto kur gjejmë donator)

## Neni 4

### Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partner në zbatimin e programit dhe të punojmë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve.

Bashkia Lezhe dhe Kryqi i Kuq caktojnë persona kontakti që do të jenë pjesë e komunikimit mes palëve, koordinimit të veprimeve dhe monitorimit hap pas hapi të zbatimit të programit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike informuese dhe vendimmarrëse.

Në raste të caktuara, në marrëveshje mes tyre, Bashkia Lezhë dhe Kryqi i Kuq, krijojnë grupe të përbashkëta teknike për hartimin e propozimeve konkrete për ofrim shërbimesh apo ndryshime politikash vendore, për të paraqitur për miratim në këshillin bashkiak.

## Neni 5

### Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri në 31.12.2026 me të drejte perseritje.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë marrëveshje.

Çdo ndryshim apo shtesë në këtë marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

## Neni 6

### Modifikimi dhe ndërprerja

Marrëveshja mund të modifikohet vetëm me kërkesë dhe konsensus të palëve.

Ndërprerja e marrëveshjes së lartpërmendur do të vijë si rezultat i mospërmbushjes të të drejtave dhe detyrimeve nga palët nënshkruese të kësaj marrëveshje.

Secila nga palët duhet të njoftojë palen tjetër me shkrim, jo më pak se 30 dite përpara përfundimit të marrëdhënieve të marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbush të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve .

## Neni 7

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët .

## Neni 8

### Dispozitat e Fundit

Palët përgjigjen reciprocikisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partner në zbatimin e saj duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

**Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin Bashkiak.**

### Neni 9


#### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja e bashkëpunimit mbahet në gjuhën shqipe, në 5 (pesë) kopje origjinale, 2 (dy) për secilën palë dhe nënshkruhet e hyn në fuqi sot, më datë \_\_\_\_\_. 2026

Bashkia Lezhë

Kryetar


Pjerin Ndreu



Kryqi e Kuq Shqiptar Dega Lezhë

Sekretar i Degës

Blendi Gjeçi



Nr. 1581/prot  
Dt. 8-2-26



103

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 117/4 Prot.

Lezhë, më 09.02. 2026

**Lënda:** Kthim përgjigje në lidhje me vendimin nr.3, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

### KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

### KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.1600 prot, datë 02.02.2026 “Dërgim vendimesh të këshillit të bashkisë Lezhë“, protokolluar në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë me nr.117 prot, datë 03.02.2026, bazuar në nenet 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“ i ndryshuar, pasi shqyrtuam vendimin nr.3, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e akt-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Lezhë“ si dhe dokumentacionin bashkëngjitur këtij vendimi konstatojmë si më poshtë:

Ky vendim në bazë të nenit 3, pika 2 të ligjit nr 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë“ nuk është akt me karakter normativ.

Vendimi nr.3, datë 28.01.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë është akt administrativ individual pasi u drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht (“bashkisë Lezhë–përfaqësuar nga kryetari i bashkisë z.Pjerin Ndreu dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Lezhë, përfaqësuar nga zj.Jolanda Gjeçi, sekretar i Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Lezhë), krijon një marrëdhënie juridike konkrete mes palëve të sipërpërmendura dhe ka një pasojë konkrete (ofrimi i shërbimeve për funksionimin e qendres multifunkionale pranë gjimnazit të vjetër “Hydajet Lezhë“), si dhe është i shteruar në zbatimin e tij (e vlefshme deri me 31.12.2026 me të drejtë përsëritje).

Në bazë të nenit 8 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“ të ndryshuar ; a) Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

-Verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Referuar nenit 4 të ligjit nr.107/2016, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër verifikimi ligjor i vendimit nr.3, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e akt-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, dega Lezhë“, si një akt adiministrativ individual nuk i nënshtrohet verifikimit ligjor nga ana e prefektit por hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Taulant MALSHI**

